

Siguri dhe qëndrueshmëri në shfrytëzimin e minierave duke përdorur standardet ndërkombëtare



Shfrytëzimi i minierave është një aktivitet i përkohshëm, me miniera që hapen kudo, përgjatë disa viteve dhe disa dekadave. Megjithatë, gjithnjë e më shumë, ajo që ndodh pasi një minierë mbyllet, dhe ndikimi që kjo ka në komunitetin zonal dhe mjedisin, ndikon ndjeshëm në konkurrencën e operatorëve të shfrytëzimit të minierave.

Një nënkomitet i ri i ISO-s mbi menaxhimin e procesit të rehabilitimit në shfrytëzimin e minierave (ISO/TC 82/SC 7) është krijuar për të hartuar Standarde Ndërkombëtare, të cilat mund të ndihmojnë në zvogëlimin e dëmtimeve afatgjata nga aktiviteti i shfrytëzimit të minierave, duke rritur cilësinë e jetës të banorëve që jetojnë në këtë zonë dhe duke ndihmuar të përmirësojnë marrëdhëniet midis industrisë së shfrytëzimit mineral dhe banorëve që jetojnë në këto zona.

Prof. Sun Joon Kim, kryetar i nënkomitetit ISO/TC 82/SC 7, “*Menaxhimi i rehabilitimit të minierave, tha: “Antagonizmi midis zhvilluesve, të cilët vendosin si prioritet fitimin e banorëve të këtyre zonave, ka të bëjë me shkatërrimin ambientaal dhe dëmtimin e komuniteteve zonale, ndonjëherë mund të rritet drejt një konflikti, i cili shkon përtej një ndërhyrjeje të arsyeshme. Standardet Ndërkombëtare për Menaxhimin e rehabilitimit të shfrytëzimit mineral mund të jenë të dobishme duke qenë se këto standarde/udhëzuesa të pranuar ndërkombëtarisht ndihmojnë në mënjanimin e pretendimeve të tepërta ose të përfitimeve nga njëra palë, drejt një situatë të favorshme”.*



Ndërkohë që shumë vende kanë në zbatim standarde të mira kombëtare, deri tani ka munguar një qasje globale. Menaxhimi i një veprimtarie rehabilituese është shumë kompleks; ajo fillon shumë kohë para se një shfrytëzim mineral të fillojë dhe nuk ndalon për shumë vite pas orës së fundit të qymyrit të nxjerrë.

Projektet e reja të shfrytëzimit mineral në përgjithësi janë të mirë përcaktuara dhe një plan rehabilitues është i detyrueshëm, por një standard i përbashkët global në drejtim të menaxhimit të këtij plani rehabilitues nuk është ende në dispozicion. Përveç kësaj, pothuajse çdo vend ka eksperiencë problematike të disa llojeve me miniera, të cilat nuk janë më operacionale, shpesh lidhen me pirgjet e dheut dhe pellgjet me mbetje.

Siç edhe shpjegon, Reinhard Reinartz, Drejtuesi i ISO/TC 82, *Shfrytëzimi mineral*, “Rehabilitimi i minierave është një fushë shumë e gjerë, e cila përgjithësisht përfshin ri-integrimin e vazhdueshëm dhe atë pasues të hapësirave mjedisore të prekura nga shfrytëzimi mineral, gjatë dhe pas aktivitetit

të shfrytëzimit mineral. Shumë çeshtje duhet të merren parasysh nga një pikëpamje afatgjatë, si hidrologjia, nivelet e ndotjes së ujit, mbetjet, dhe dhe qëndrueshmëria e shpatit, shembja e ngrehinave etj”.

Standardet e të ardhmes për shfrytëzim të ndryshëm dhe të fuqishëm të minierave

Zhvillimi i standardeve në sektorin e shfrytëzimit të minierave është një sfidë e madhe dhe pjesa më e madhe e standardeve rajonale ekzistuese do të shërbenin si shembuj pozitiv për t’u përdorur në nivel global. Kjo do të jetë një nga detyrat e ardhshme të komitetit teknik të ISO-s.

Në këtë drejtim, Prof. Sun Joon Kim theksoi: “Qëllimi i standardizimit të minierave nuk është të specifikojë teknologji apo kriterie specifike, por të sugjerojë një udhëzues të përgjithshëm që mund të zbatohet globalisht. Në brendësi të këtij udhëzuesi të përgjithshëm, mund të gjenden më të detajuara fushat dhe standardet për çdo situatë që mund të zhvillohet, nëse është e nevojshme, situata specifike mund të standardizohen në mënyrë të pavarur.

Reinhard Reinartz sqaron: “Hapi i parë dhe më i rëndësishëm për ISO/TC 82 është të identifikojë dhe kuptojë në detaje këto nevoja të ndryshme, më pas do të jemi në gjendje të identifikojmë bazën e përbashkët me çeshtje dhe fusha të tjera, duke u siguruar që ato të mos jenë raste të veçuara. Për këtë arsye, mbajmë lidhje intensive me komitetet teknike të ISO që kanë lidhje, veçanërisht në fushën e makinerive. Grupe të përbashkëta pune janë krijuar jo vetëm për të shkëmbyer rezultatet por gjithashtu të bien dakord për veprimin e radhës dhe së fundi, nëse është e mundur, një standard të përbashkët ndërdisiplinor. Kjo do të sigurojë përhapjen e praktikave më të mira në të mirë të industrisë dhe do të identifikojë nevojat se ku duhet të ndërhyhet specifikisht në këtë industri.

Industria e shfrytëzimit mineral është aktualisht e domosdoshme për përmbushjen e kërkesave të sotme të energjisë, të cilat mund të luajnë një rol themelor në shumë ekonomi kombëtare. Gjithsesi kjo industri duhet të plotësojë kërkesat mjedisore, si dhe shfrytëzimi pa kriter i burimeve të pakta nuk duhet konsideruar si barrë për brezat e ardhshëm. Kjo është arsyeja pse industria e shfrytëzimit mineral ka një rol të patjetërsueshëm në sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm.



Reinhard Reinartz, Chair of
ISO/TC 82